

FAKULTETI I MENXHIMIT TË TURIZMIT, HOTELERISË DHE MJEDISIT

Analiza e kërkesave të studentëve dhe nevojave të palëve të interesit për
programet bachelor dhe master në fushën e turizmit

RAPORT STATISTIKOR

SEPTEMBER 5, 2023

1. Hyrje

Në një periudhë kur nevojat e tregut të punës dhe pritshmëritë e studentëve po ndryshojnë vazhdimisht, analiza e kërkesave të studentëve dhe nevojave të industrisë për programet Bachelor dhe Master ka një rëndësi të veçantë. Ky raport synon të hedhë dritë mbi dinamikat e ndryshme që karakterizojnë këto nivele të studimit, duke shqyrtuar në thellësi preferencat, pritshmëritë dhe synimet e studentëve, si dhe nevojat e bizneseve. Përmes analizës së të dhënave statistikore, synojmë të identifikojmë trendet kryesore dhe të ofrojmë një pasqyrë të qartë mbi këto kërkesa dhe nevoja. Rezultatet dhe rekomandimet e paraqitura kanë kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit dhe përputhjen më të mirë me sfidat dhe mundësitë e tregut të punës.

Objektivat e raportit

Objekti kryesor i këtij raporti është identifikimi i kërkesave të studentëve dhe nevojave të industrisë për programet Bachelor dhe Master në FMTHM.

Synimi kryesor i këtij raporti është: **Analiza e përputhshmërisë së programeve me kërkesat e studentëve dhe industrisë.**

2. Metodologjia

Për të përcaktuar mostrën e paleve me interes, është përdorur metoda e zgjedhjes së rastesishme të përzgjedhur (Stratified Random Sampling), ndërsa për të përcaktuar mostrën e studentëve është aplikuar metoda e zgjedhjes së rastesishme të thjeshtë (Simple Random Sampling). Instrumenti i përdorur për të mbledhur të dhënat në të dy rastet është pyetësi online i krijuar me pyetje të hapura dhe të mbyllura. Për krijimin e pyetësorit online është përdorur programi Survio (<https://www.survio.com/en/>). Nga ky program janë nxjerrë statistika përshkruese dhe të dhënat cilësore nga pyetjet e hapura. Madhësia e mostrës së studentëve është 115, ndërsa madhësia e mostrës së paleve me interes është 15.

3. Raport statistikor me studentët active dhe të diplomuarit e FMTHM

Ky raport statistik fokusohet në dy aspekte kyçe: studentët aktivë, si dhe të diplomuarit e FMTHM. Në vijim, janë prezantuar të dhëna të detajuara, të cilat kanë shërbyer për të nxjerrë përfundime dhe rekomandime të nevojshme për ristrukturimin e programit Bachelor dhe hartimin e programit Master në fushën e turizmit dhe hotelerisë.

3.1. Analiza e të dhenave

1. Moshë dhe Gjinia

	18-28	29-39	40-50	Total
F	38	17	12	67
M	17	20	11	48
Total	55	37	23	115

Burimi: FMTHM

Nga të dhënat e prezantuara rezulton se 67 respondentë janë të gjinisë femërore dhe 48 janë të gjinisë mashkullore, ndërsa në numër më të lartë janë në intervalin e moshës 18-28 vjeç.


2. Niveli i edukimit dhe nevoja e studentëve për programin master.

	Student	I diplomuar në nivelin bachelor	Total
Po	29	57	86
Jo	5	21	26
Total	34	78	112

Burimi: FMTHM

Duke u bazuar në rezultatet e prezantuara, vijnë në përfundimin se studentët e diplomuar në nivelin bachelor, si edhe studentët aktualë në FMTHM, kanë kërkesa të larta për programin master në fushën e menaxhimit të turizmit.

3. Interesi për të punuar në industrinë e turizmit




4. Raporti ndërmjet studentëve aktivë dhe të diplomuarve, si dhe përpjekjet për të punuar në industrinë e turizmit

	Student	I diplomuar në nivelin bachelor	Total
Po	18	53	71
Jo	16	25	41
Total	34	78	112

Burimi: FMTHM

Nga të dhënat e paraqitura, rezulton se mbi 50% e studentëve janë shumë të interesuar për të punuar në industrinë e turizmit.


5. Në lidhje me pyetjen se në cilin nga opsionet e mëposhtme keni një interesim më të lartë për të punuar, rezulton që:



Burimi:FMTHM

Një përqindje mbi 25% e respondentëve janë të interesuar për të punuar në sektorin e organizimit të udhëtimeve, ndërsa 16.6% në sektorin e akomodimit.

6. Interesimi i studentëve aktivë dhe të diplomuarëve për profesionet e mëposhtme në turizëm



Burimi:FMTHM

Nga të dhënat e paraqitura, shohim se respondentët janë shumë të interesuar për të punuar si menaxher në industrinë e turizmit dhe menaxher i marrëdhënieve me publikun.

7. Barrierat kryesore që kanë hasur në gjetjen e punës në fushën e turizmit


	Numri	%
Paga të ulëta	49	42.2%
Mungesa e zakoneve të mira të punës	30	25.9%
Mungesa e informacionit për mundësitë e punësimit në turizëm	27	23.3%
Mungesa e përvojës së punës së të rinjve	27	23.3%
Mungesa e aftësive teknike/profesionale	22	19%
Orare të vështira të punës (orë të gjata, turne të vona)	15	12.9%
Mungesa e aftësive të gjuhëve të huaja	14	12.1%
Vendndodhja gjeografike (distanca nga puna)	13	11.2%
Diskriminimi (gjinia, mosha, kushtet shëndetësore, etj.)	12	10.3%
Kontrata të përkohshme tre mujore	8	6.9%
Mjedisi i rrezikshëm ose i rrezikshëm i punës	8	6.9%

Other...	6	5.2%
Mungesa e mbështetjes familjare në ndjekjen e një rruge karriere turistike	5	4.3%
Aftësitë e dobëta për shërbimin ndaj klientit	5	4.3%
Kujdesi për fëmijët	2	1.7%

Burimi:FMTHM

Paga të ulëta (42.2%): Një shqetësim i dukshëm i respondentëve është niveli i pagave në sektorin e turizmit. Kjo mund të ndikojë në përzgjedhjen e profesionit dhe motivimin e tyre për të qëndruar në këtë fushë.


8. Rëndësia e programeve të studimeve në fushën e turizmit dhe hoteleri të jenë në përputhshmeri me nevojat dhe kërkesat e tregut



Burimi:FMTHM

Mbi 80% e respondentëve mendojnë se është shumë e rëndësishme që programet e studimit të jenë në harmoni me nevojat dhe kërkesat e tregut.

9. Sa besoni se programet turistike të FMTHM duhet të ofrojnë mundësi për studentët për të studiuar jashtë vendit ose për të marrë pjesë në programe shkëmbimi ndërkombëtar?



Burimi :FMTHM

Programet e studimit në FMTHM shihen si një mundësi e madhe nga respondentët për të bërë pjesë në programe shkëmbimi ndërkombëtar.

10. Aftësitë të cilat janë më të rëndësishme për studentët aktivë dhe të diplomuarët në fushën e turizmit janë:

	Student	I diplomuar në nivelin bachelor	Total
Aftësi në komunikim	10	19	29
Aftësi për zgjidhjen e problemeve	6	6	12
Bashkëpunim dhe Punë ekipore	3	13	16
Aftësi teknike drejtuese dhe konceptuale	5	21	26
Aftësi promovuese dhe në menaxhimin e marrëdhënieve me konsumatorët	10	19	29

Burimi:FMTHM

Sipas përgjigjeve të respondentëve, aftësitë në komunikim, aftësitë teknike, aftësitë drejtuese, aftësitë promovuese dhe puna në grup konsiderohen si më të rëndësishme për studentet aktive dhe të diplomuarit në fushën e turizmit.

11. Mendime shtesë rreth njohurive, perceptimeve dhe interesave të tyre drejt turizmit (të dhëna cilësore)

Në vijim janë përmbledhur përgjigjet e respondentëve :

1. Zgjerimi i njohurive në fushën e turizmit në nivelet më të larta të studimit, si Master dhe Doktoraturë;
2. Studimi më i mirë i turizmit të qëndrueshëm përfshin një kombinim të lëndëve teorike dhe praktike. Përvoja në terren dhe praktika në industrinë e turizmit janë të rëndësishme për të zhvilluar një kuptim të thellë të sektorit. Lëndët e studimit mund të përfshijnë menaxhimin e destinacioneve turistike, marketingun turistik, turizmin kulturor, zhvillimin e produkteve turistike, financën në industrinë e turizmit, dhe shumë të tjera. Gjithashtu, është e rëndësishme të keni një qasje multidisiplinore dhe të jeni të gatshëm për të mësuar nga eksperiencat të ndryshme në fushën e turizmit.

3. Studimi i masterit në turizëm ofron aftësi të forta në zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve turistike. Do të mësosh të planifikosh, të organizosh dhe të drejtosh projekte të ndryshme në industrinë e turizmit, duke përfshirë zhvillimin e destinacioneve turistike, organizimin e eventeve turistike, krijimin e produkteve inovative turistike, dhe shumë të tjera. Kjo do të të përgatisë për të bërë ndikim pozitiv dhe të suksesshëm në industri.
4. Studimi i masterit në turizëm ofron vlera të mëdha në zhvillimin e aftësive profesionale në menaxhimin e lartë të turizmit. Nëpërmjet këtij programi, do të fitoni njohuri të thella në lëndët themelore të menaxhimit të turizmit, siç janë strategjia e marketingut, financat, menaxhimi i destinacioneve turistike, zhvillimi i produkteve turistike, dhe shumë të tjera. Kjo do të ju përgatisë për të udhëhequr dhe menaxhuar me sukses organizata dhe projekte turistike në nivel të lartë.
5. Studimet master në turizëm janë të akredituara nga organizata të specializuara për të siguruar cilësi dhe integritet. Akreditimi ofron mundësinë për të marrë një diplomë të njohur dhe për të gëzuar respekt në tregun e punës. Kjo të lejon të përfitosh njohuri të thellë dhe specializim në fusha të ndryshme të turizmit. Është një mundësi e shkëlqyeshme për të avancuar karrierën dhe për të ndikuar në zhvillimin e industrisë së turizmit.
6. Studimet master në turizëm janë një mundësi e shkëlqyeshme për të thelluar njohuritë dhe për të avancuar në karrierën në industrinë e turizmit. Do të keni mundësinë të eksploroni temat e ndryshme të turizmit dhe të zhvilloni aftësitë dhe ekspertizën tuaj në këtë fushë.
7. Studimet master në fushën e turizmit kanë një rëndësi të madhe. Ato ofrojnë njohuri të thellë dhe specializim në fusha të ndryshme si menaxhimi i destinacioneve turistike, planifikimi strategjik, marketingu turistik dhe zhvillimi i produkteve turistike inovative. Studimet master janë një mundësi e shkëlqyeshme për të avancuar karrierën në industrinë e turizmit.
8. Studimet e larta në turizëm ofrojnë njohuri të thellë dhe specializim në fusha të ndryshme të industrisë së turizmit. Këto programe përfshijnë të gjitha nivelet e studimeve, duke filluar nga bachelor deri në doktoraturë. Ato ofrojnë mundësi për të

mësuar rreth menaxhimit të destinacioneve turistike, marketingut turistik, zhvillimit të produkteve turistike, dhe shumë më tepër. Këto studime janë të rëndësishme për ata që dëshirojnë të bëhen ekspertë në fushën e turizmit dhe të ndikojnë në zhvillimin e kësaj industrie.

9. Stafi akademik duhet të punojë me përkushtim dhe profesionalizëm në procesin e akreditimit të nivelit të studimeve master në turizëm. Ata duhet të sigurojnë që programi i studimit të plotësojë standardet dhe kriteret e nevojshme për të ofruar një edukim cilësor dhe të përshtatshëm për studentët. Stafi akademik duhet të përgatitet në mënyrë të vazhdueshme, të ndjekë zhvillimet e fundit në industrinë e turizmit dhe të sigurojë që materialet mësimore dhe metodologjitë e mësimdhënies të jenë të përditësuara dhe të përputhshme me kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu, ata duhet të bashkëpunojnë me organizatat dhe institucionet relevante në industrinë e turizmit për të siguruar një lidhje të fortë midis teorisë dhe praktikës.
10. Shtesat në njohuri të reja në hulumtimin e tregut turistik, trajnime, udhetime, programe të reja, etj., janë të rëndësishme.
11. Niveli master në turizëm kërkohet për të pasuruar njohuritë dhe për të avancuar në karrierën në industrinë e turizmit. Kjo ofron mundësi për të zhvilluar ekspertizën në fusha të ndryshme të turizmit dhe për të kuptuar më mirë sfidat dhe trendet e kësaj industri. Nëpërmjet programit të studimit të nivelit master, studentët zhvillojnë aftësitë e tyre analitike, menaxheriale dhe inovative, dhe janë në gjendje të kontribuojnë në zhvillimin e strategjive dhe politikave të turizmit në nivel lokal dhe ndërkombëtar.
12. Në studimet master në turizëm, ku fokusi është tek Menaxhimi i turizmit të qëndrueshëm, profesionalizmi është thelbësor. Këto programe ofrojnë njohuri të thellë dhe specializim në fusha të ndryshme të turizmit. Kërkesat akademike, përfshirja në projekte praktike dhe krijimi i lidhjeve profesionale janë pjesë integrale e studimeve master në turizëm për të zhvilluar një karrierë të suksesshme.
13. Të kesh një program ku studentët mund të bëjnë njëkohësisht punë praktike me pagesë do të ishte ndihmese e madhe për studentët, si financiarisht, ashtu edhe profesionalisht.

14. Programet e shkëmbimit me universitete të tjera në Europë do ishin një plus i madh për studentët në këtë drejtim.
15. Mendoj se është shumë e nevojshme për një program Master në fushën e turizmit të qëndrueshëm.
16. Konferencat e zhvillimit të turizmit në studimet e larta janë shumë të rëndësishme për të ndarë dhe shkëmbyer njohuri dhe përvojë në fushën e turizmit. Ato ofrojnë platformë për diskutime, prezantime dhe prezantime të studimeve të fundit, strategji inovative dhe zhvillime të reja në industrinë. Pjesëmarrja në këto konferenca të jep mundësinë të njihesh me profesionistë të tjerë dhe të krijosh kontakte të rëndësishme në fushën e studimeve të larta në turizëm.

4. Raport statistikor për palët e interesit (stakeholders) të industrisë së turizmit

Analiza e kërkesave të industrisë për programe studimi është një proces i rëndësishëm për të siguruar që FMTHM po ofron programet e duhura që përgatitin studentët për sfidat dhe mundësitë e tregut të punës. Në vijim, është një analizë e mundshme për të identifikuar kërkesat e industrisë në lidhje me programet e studimit bachelor dhe master.

4.1. Analiza e të dhënave

1. Palët e interesit të përfshira ne hulumim

Komuna e Pejës
Komuna e Deçanit
Unioni i Turizmit të Kosovës
Balkan Natural Adventure
Hotel Dukagjini
Hotel&Restaurant te Liqeni
Villa Limi-Resort
Shoqata bjeshkatore "RRASA E ZOGUT" Junik
Kullaguesthouse shpk bujtin turistike
Gold
Ansambli Folklorik Autokton Rugova
Roll
Bujtina Kacaku, bujtine/guesthouse
Biznes turistik-Klinë
Art Resort SHPK, bujtina

2. Fushat ku kanë sfida më së shumti palët me interes


Nuk ka sfida	Nuk ka sfida	Ka sfida	Pa opinion
Përdorimi i TIK-ut për të përmirësuar produktivitetin	1	11	3
Praktikat joetike ose korrupsioni	5	5	5
Shërbimi ndaj klientit	7	7	1
Higjiena dhe përgatitja e ushqimit	6	7	2
Shëndeti dhe siguria e mysafirëve	4	10	1
Shëndeti dhe siguria e personelit	4	9	2
Mirëmbajtja dhe riparimi i objekteve	2	10	3
Menaxhimi financiar	4	9	2
Menaxhimi i burimeve njerëzore	2	12	1
Mungesa e ndërgjegjësimit turistik nga banorët	3	11	1
Mungesa e mundësive për zhvillimin dhe trajnimin e stafit	2	13	0

Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore	3	12	0
Publiciteti dhe marketingu	4	11	0
Ndikimi i ndryshimeve klimatike	3	10	2
Zhvillimi i tregjeve të specializuara të turizmit	2	12	1
Hulumtimi i tregut	3	11	1
Legjislacioni/ politika publike në lidhje me turizmin dhe hotelerinë	2	10	3

Burimi:FMTHM

Ka një numër të konsiderueshëm të palëve që e shohin përdorimin e TIK-ut si sfidë, ndoshta për shkak të mungesës së infrastrukturës së nevojshme apo njohurive teknologjike. Po ashtu, sfidat më të mëdha përfshijnë shëndetin dhe sigurinë e mysafirëve, menaxhimin e burimeve njerëzore, hulumtimin e tregut, mundësitë për zhvillimin dhe trajnimin e stafit, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, si dhe publicitetin dhe marketingun.

3. Njohurit per programet aktualet te FMTHM



Nga të dhënat e prezantuar rezultojnë që 40% e respondentëve kanë mesatarisht njohuri për programin aktual të FMTHM.

4. Në cilën nga fushat e mëposhtme mendoni se programet aktuale të turizmit dhe hotelerisë kanë nevojë për përmirësim? (Zgjidhni të gjitha ato që zbatohen)

Zbatimi praktik i njohurive	10	66.7%
Krijimi i mundësive për bashkëpunim me profesionistë të industrisë	8	53.3%
Zhvillimi profesional dhe gatishmëria për karrierë	4	26.7%
Integrimi i teknologjive në zhvillim të programit	4	26.7%
Other...	1	6.7%

Burimi:FMTHM

Ky rezultat tregon se shumica e dërrmuese e respondentëve (66.7%) shohin nevojë për përmirësim në zbatimin praktik të njohurive. Gjithashtu, një përqindje e konsiderueshme (53.3%) vlerëson se ka hapësirë për të përmirësuar krijimin e mundësive për bashkëpunim me profesionistë të industrisë. Në anën tjetër, një pjesë më e vogël e respondentëve (26.7%) beson se ka fusha për

të zhvilluar përmirësime në zhvillimin profesional dhe gatishmërinë për karrierë, si dhe në integrimin e teknologjive në zhvillimin e programit. Një përqindje minimale (6.7%) ka propozuar aspekte tjera si fusha për përmirësim, duke theksuar nevojën për një analizë më të thelluar për të identifikuar nevojat konkrete.


5. Programet tona të turizmit i përgatisin studentët në mënyrë adekuate për karrierë:

ANSWER	AMOUNT	RATIO
Po	8	53.3%
Nuk jam i sigurt	7	46.7%
Jo	0	0%

Burimi: FMTHM

Ky rezultat tregon se një përqindje e konsiderueshme e respondentëve (53.3%) vlerëson se programet e turizmit të FMTHM përgatisin studentët në mënyrë adekuate për karrierë në industrinë e turizmit. Në anën tjetër, 46.7% e respondentëve nuk janë të sigurt në këtë aspekt. Nuk ka përgjigje negative në këtë rast, duke treguar një perceptim pozitiv në përgjithësi për përgatitjen e studentëve për karrierë në fushën e turizmit nga ana e programeve të ofruara.


6. Sa mendoni se programet e turizmit dhe hotelerisë të fakulteti tonë përputhen me tendencat dhe kërkesat aktuale të industrisë?



Burimi:FMTHM

Ky rezultat tregon se një pjesë e konsiderueshme e respondentëve (46.7%) vlerëson se programet e turizmit dhe hotelerisë në fakultetin e tyre përputhen mirë me tendencat dhe kërkesat aktuale të industrisë. Në të njëjtën kohë, 26.7% e pjesëmarrësve nuk janë të sigurt në përputhjen e programeve me kërkesat e aktualizuara, ndërsa 13.3% i vlerësojnë ato si jo të mira. Një pjesë e vogël (13.3%) e respondentëve mendon se programet përshtaten shumë mirë me tendencat dhe kërkesat e industrisë.

7. Sa të vlefshme mendoni se janë leksionet e realizuar nga ekspertet e industrisë dhe mundësitë e rrjetëzimit për studentët në programet e turizmit?



Burimi:FMTHM

Nga të dhënat e paraqitura në grafik rezulton se mbi 46% e pjesëmarrësve shohin si mundësi të mirë për studentët që të realizohen leksione nga ekspertë të industrisë.

8. Fushat të cilat mendojnë që programet aktuale kanë nevojë për përmirësim (pyetje e hapur):

Zgjerimi i njohurive në zbatimin praktik të shërbimeve dhe sjelljes ndaj klientëve.

- Ruajtja, kultivimi dhe promovimi i trashëgimisë shpirtërore dhe materiale, baza për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit.
- Mendoj se dijenitë praktike të përdorimit të mediave sociale dhe marketingut digjital janë shumë të nevojshme. Bashkëpunimi me operatorë turistik gjithashtu është një mungesë e madhe.
- Menaxhimi dhe ambienti.

- Fleksibiliteti i orareve të ushtrimeve për studentët të cilët janë të punësuar njëkohësisht.
- Fusha praktike.

9. Aftësitë dhe kompetencat kryesore që duhet të zotërojnë profesionistët në fushën e turizmit dhe hotelerisë(pyetje e hapur):


Të zotëroj aftësi organizative, kreative dhe promovuese.

- Njohuri në shërbimin ndaj klientëve, trajnimin e stafit, analizimin e konkurrencës dhe zgjerimin e njohurive në promovimin e biznesit jashtë vendit.
- Menaxhimi i destinacionit dhe menaxhimi në hoteleri.
- Komunikimi në gjuhë të huaja dhe kuptimi i kulturave të huaja.
- Kompetencë kryesore, mendoj se duhet të jetë profesionalizmi në të gjitha fushat e turizmit dhe hotelerisë, si korrektesia, mikpritja, informacioni, marketingu, etj.
- Aftësia për mirë-menaxhimin e anës së shërbimeve të cilat ofrohen dhe përshtatja e tyre me kërkesat e turistëve dhe klientelës së tyre.

10. Cilat lëndë ose përqendrime zgjedhore do të rekomandonit të përfshihen në kurrikulë në mënyrë që të përmbushen nevojat e industrisë në zhvillim(pyetje e hapur)?

- Turizmi i qëndrueshëm
- Turizmi: menaxhim dhe marketing.
- Trashëgimia kulturore
- Shkathtësitë e komunikimit
- Shërbimi ndaj klientit dhe promovimi i biznesit
- Mediat dixhitale dhe platformat digjitale të turizmit.
- Lëndë që nxisin edukimin në menaxhim të destinacionit.
- Gjuha angleze.

11. A besoni se FMTHM duhet të ofroj programet e nivelit master në fushën e turizmit dhe hotelerisë?



Mbi 86% e mendojnë se FMTHM duhet të ofrojë programin master në fushën e turizmit dhe hotelerisë.

12. Për cilat fusha specializimi keni nevojë më së shumti (kjo pyetje ka lidhshmëri me programin e nivelit master) :

Ansëer	Amount	Ratio
Turizëm të qëndrueshëm	9	60%
Menaxhimi i turizmit dhe hotelerisë	9	60%
Marketing turistik	7	46.7%
Menaxhimi i burimeve njerëzore	4	26.7%
Menaxhimi i destinacioneve	4	26.7%
Administrimi i udhëtimeve dhe turizmit	3	20%
Planifikimi dhe menaxhimi i ngjarjeve	1	6.7%
Other...	0	0%

Tabela tregon se ekziston një kërkesë e lartë për specializim në këto fusha të caktuara në nivelin master të programit në FMTHM. Sipas të dhënave fushat e specializimit më të kërkuara janë "Turizëm i qëndrueshëm" dhe "Menaxhimi i turizmit dhe hotelerisë", të cilat kanë një përqindje të njëjtë të 60%. "Marketingu turistik" gjithashtu është e kërkuar, duke arritur në 46.7%. Ndërsa fushat si "Menaxhimi i burimeve njerëzore", "Menaxhimi i destinacioneve", "Administrimi i udhëtimeve dhe turizmit" janë gjithashtu të kërkuara, por në një përqindje më të ulët.

Conclusion

Në baze të rezultateve nga pjesa e hulumtimit ku focus ishin student active dhe te diplomarit e FMTHM janë nxjerr këto përfundime:

- Nga analiza e të dhënave, duket se ka një dominim të përqindjes së studenteve të gjinisë femëre, me 67% të përgjigjeve, krahasuar me 48% të përgjigjeve të studentëve mashkull. Gjithashtu, është e vërejtur se përqindja më e lartë e studentëve ndodhet në grupmoshën 18-28 vjeç.
- Studentët e diplomuar në nivelin e bachelor dhe ata që aktualisht janë studentë në FMTHM kanë shfaqur një kërkesë të lartë për programin master në fushën e menaxhimit të turizmit të qëndrueshëm. Kjo tregon për një interes të spikatur në zhvillimin e njohurive dhe aftësive në këtë fushë nga ana e studentëve.
- Nga të dhënat, shihet që mbi 50% e studentëve janë shumë të interesuar për të punuar në industrinë e turizmit. Kjo tregon për një shpërqendrim të madh drejt kësaj fushe dhe një potencial të lartë të angazhimit në karrierë pas përfundimit të studimeve.
- Mbi 81% e respondentëve vlerësojnë se është shumë e rëndësishme që programet e studimit të jenë në harmoni me nevojat dhe kërkesat e tregut. Programet e studimit të FMTHM shihen si një mundësi të madhe për të qenë pjesë e programeve ndërkombëtare shkëmbimi. Nga perspektiva e respondentëve, aftësitë kryesore përfshijnë aftësi në komunikim, aftësi teknike, drejtuese, aftësi promovuese, dhe aftësi në punën ekipore, duke treguar se këto cilësi janë të rëndësishme për një karrierë të suksesshme në fushën e turizmit.

- Për të përparuar në fushën e turizmit të qëndrueshëm, është e rëndësishme të kombineohet njohuria teorike me atë praktike. Programet e studimit duhet të përfshijnë lëndë të ndryshme që mbulojnë menaxhimin e destinacioneve turistike, marketingun turistik, zhvillimin e produkteve turistike, financën në industrinë e turizmit dhe të tjerë.
- Programet master në turizëm ofrojnë një mundësi të shkëlqyeshme për të zhvilluar aftësi në menaxhimin e projekteve turistike. Përvoja në planifikim, organizim dhe drejtim të projekteve të ndryshme në industrinë e turizmit siguron një përgatitje të mirë për ndikim pozitiv dhe sukses në këtë sektor.
- Nëpërmjet studimeve master në turizëm, studentët kanë mundësinë të përparojnë personalisht dhe profesionalisht. Kjo përfshin eksplorimin e temave të ndryshme të turizmit dhe zhvillimin e aftësive dhe ekspertizës në këtë fushë, duke hapur dyer për mundësi të shumta karriere.
- Për të siguruar një edukim cilësor, programet master në turizëm duhet të jenë të përshatshme me zhvillimet e fundit në industrinë dhe duhet të ofrojnë një kombinim të lëndëve të teorike dhe praktike. Bashkëpunimi me organizata dhe institucione relevante në industrinë e turizmit mund të rrisë lidhjen midis teorisë dhe praktikës. Programet master në turizëm duhet të inkorporojnë njohuri të reja të hulumtimit të tregut turistik, trajnimeve, udhetimeve, dhe programet e reja. Bashkëpunimi me universitete të tjera në Europë dhe kontributi në konferenca të zhvillimit të turizmit janë me rëndësi për të përmirësuar edukimin dhe aftësitë profesionale.
- Stafi akademik duhet të punojë me përkushtim dhe profesionalizëm në përgatitjen dhe akreditimin e programeve master në turizëm. Kjo përfshin ndjekjen e zhvillimeve në industrinë e turizmit dhe sigurimin e lidhjes së fortë midis teorisë dhe praktikës. Programet duhet të ofrojnë mundësi për punë praktike me pagesë dhe të kujdesen për të përgatitur studentët për tregun e punës.

Në baze të rezultateve nga pjesa e hulumtimit ku focus ishin palët me interes janë nxjerr këto përfundime:

- Ka një numër të konsiderueshëm të palëve që e shohin përdorimin e TIK-ut si sfidë, veçanërisht për shkak të mungesës së infrastrukturës apo njohurive teknologjike.
- Shumica dërrmuese e respondentëve (66.7%) shohin nevojë për përmirësim në zbatimin praktik të njohurive.
- Përqindja e konsiderueshme (53.3%) vlerëson se ka hapësirë për të përmirësuar krijimin e mundësive për bashkëpunim me profesionistë të industrisë.
- Një përqindje e lartë (53.3%) vlerëson se programet e turizmit të FMTHM përgatisin studentët në mënyrë adekuate për karrierë në industrinë e turizmit.
- Pjesa më e madhe (46.7%) vlerëson se programet përputhen mirë me tendencat dhe kërkesat aktuale të industrisë.
- Mbi 46% e pjesëmarrësve shohin si mundësi të mirë për studentët që të realizohen leksione nga ekspertë të industrisë.
- Hulumtimi dhe trajnimi i personelit në lidhje me etikën dhe parandalimin e korrupsionit mund të jenë çështje kryesore për adresim.
- Përbushja e kërkesave të klientëve për një shërbim cilësor duhet të jetë një fokus i rëndësishëm për zhvillimin e sektorit të turizmit.
- Respondentët theksuan nevojën për një përjasje më të thellë dhe të aplikueshme në zbatimin praktik të njohurive, veçanërisht në shërbimet dhe sjelljen ndaj klientëve.
- Ruajtja, kultivimi dhe promovimi i trashëgimisë shpirtërore dhe materiale u vlerësua si një bazë kritike për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të turizmit.
- Një përqindje e konsiderueshme e respondentëve shprehen se njohuritë praktike të përdorimit të mediave sociale dhe marketingut digjital janë të nevojshme.
- Bashkëpunimi me operatorë turistik u përmend si një fushë ku ka nevojë për përmirësim dhe për të adresuar mungesat ekzistuese.
- Nënvizohet nevoja për një fleksibilitet më të madh të orareve të ushtrimeve për studentët që janë të punësuar njëkohësisht.

- Aftësitë dhe kompetencat kryesore që profesionistët në fushën e turizmit dhe hotelerisë duhet të zotërojnë rezultone të jenë: Aftësi organizative, kreative dhe promovuese, njohuri të thella në shërbimin ndaj klientëve, trajnimin e stafit, analizimin e konkurrencës në komunikim efektiv në gjuhë të huaja dhe kuptim të kulturave të ndryshme.
- Rekomandimet për lëndë dhe përqendrime në kurrikulën e programeve të studimit përfshijnë: Turizmi i qëndrueshëm, menaxhimi dhe marketingu në turizëm, trashëgimia kulturore, shkathhtësitë e komunikimit, shërbimi ndaj klientit dhe promovimi i biznesit, mediat dixhitale dhe platformat digjitale të turizmit lëndë që nxisin edukimin në menaxhim të destinacionit dhe gjuha angleze.
- Analiza e përgjigjeve tregon një kërkesë të forte për FMTHM që të ofron një programi master në fushën e turizmit dhe hotelerisë në FMTHM. Në veçanti, ekziston një kërkesë e vecantë për specializim në fushat e "Turizmit të Qëndrueshëm" dhe "Menaxhimit të Turizmit dhe Hotelerisë", secila me një përqindje të njëjtë prej 60%. Kjo tregon një interes të lartë në fusha që lidhen me qëndrueshmërinë dhe menaxhimin strategjik të turizmit.